



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 178/5 prot.

Tiranë, më 5.5.2021

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 352, datë 1.3.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Iliba Bezati
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F i aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 20.4.2021, është njoftuar vendimi nr. 352, datë 1.3.2021, për subjektin e rivlerësimit znj. Iliba Bezati, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 352, datë 1.3.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, ushtron detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Apelit Vlorë dhe, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës, dhe nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin znj. Iliba Bezati ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit të

hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim referuar si IKLD), nga të cilat rezulton se:

ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit, znj. Iliba Bezati*”¹ ka referuar se:

- i. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *Bashkëshorti i subjektit ka përfiturar të ardhura në kushtet e konfliktit të interesave.*

DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, me nr. *** prot., datë ***.11.2017,² ka referuar “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati*”. Me shkresën me nr. *** prot., datë ***.2.2019³, DSIK ka përditësuar dhe ndryshuar konstatimin fillestar të bërë në raportin e parë, duke referuar për Komisionin: *papërshtatshmërinë në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit Iliba *** Bezati.*

KLGG, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁴ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 Për vlerësimin e pasurisë. Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *Në përfundim, duke e vlerësuar kriterin e pasurisë për këtë subjekt rivlerësimi, në tërësinë e tij dhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit dhe të objektivitetit, trupi gjykues çmon se pamjaftueshmëria financiare e sipërpërmendur, në vlerën totale 607,922 lekë, duke mbajtur në vëmendje sa është shprehur në paragrafin e fundit (nr. 158) të pasurisë nr. 12, si dhe faktin që kjo mangësi financiare është e shpërndarë në vite] - sikurse pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet⁵ e subjektit, nuk përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra të znj. Iliba Bezati, sipas parashikimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe/ose të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se*

¹ Shkresa e ILDKPKI me nr. ***/*** prot., datë ***.7.2018.

² Duke specifikuar se ky raport është përpiluar në mungesë të përgjigjes së një prej organeve ligjzbatuese.

³ Deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. ***, datë ***.12.2019.

⁴ Raport për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, Iliba Bezati, nr. ***/*** prot., datë ***.6.2019, i KLGG-së.

⁵ Duke mbajtur në vëmendje edhe qëndrimet jurisprudenciale në vendimet nr. 11 (JR), datë 22.11.2018 dhe nr. 11; 13; 22 (JR), 2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

znj. Iliba Bezati ka arritur një nivel të besueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, duke justifikuar dhe shpjeguar bindshëm të gjitha pasuritë e analizuar [...] (f. 43 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *Në përfundim dhe për rrjedhojë të sa është konstatuar, përshkruar dhe arsyetuar më lart, trupi gjykues mbërrin në konkluzionin se përgjatë hetimit administrativ, të kryer në mënyrë të pavarur nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte që mund të cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, apo elementë të tjerë, të mjaftueshëm që në vetvete të mund të përbënin shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në zbatim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...]* (f. 46 e vendimit). Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Bezati, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ, denoncimet e depozituara në Komision dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga kryerja e një vlerësimi të përgjithshëm të kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se, nisur nga gjendja faktiko-ligjore e konstatuar dhe e argumentuar më lart, si dhe nga konstatimet lidhur me mënyrën e të punuarit (modus operandi) të subjektit, nuk kanë rezultuar problematika që mund të klasifikohen si shkelje apo mangësi të rënda profesionale të subjektit të rivlerësimit. 295. Për rrjedhojë, në konkluzion, trupi gjykues çmon se nisur nga rrethanat e sipërpërshkruara, subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimeve të nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016. [...]* (f. 79 e vendimit). Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm vlerësimi për të tria kriteret, e për këto arsye, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a” dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë [...]*.

II. Shkaqet e ankimit

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të

Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48 - 52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në vlerësimin e akteve dhe provave të administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, në gjendjen që janë aktet, duke vlerësuar nëse vendimmarrja është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

9. Në vështrim të sa më sipër, Komisioneri Publik, pasi shqyrtoi vendimin nr. 352, datë 1.3.2021, vlerëson se përfundimet e arritura nga Komisioni për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Iliba Bezati, nuk gjejnë mbështetje në prova dhe në ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk bazohen në një hetim të gjithanshëm, të plotë dhe shterues për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

10. Komisioneri Publik, duke çmuar se ky vendim, objekt ankimi, shfaq mangësi në hetimin administrativ, vlerëson se çështjet e konstatuara, në vlerësim të akteve të administruara përbëjnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

11. Në këto kushte, Komisioneri Publik e vlerëson të nevojshme që, brenda juridiksionit rivlerësues/kontrollues të Kolegjit, ky i fundit, në shqyrtim të këtij ankimi, të riçelë hetimin gjyqësor, pasi rezulton se hetimi i Komisionit, mes te tjerash, nuk ka qenë shterues në drejtim të identifikimit të burimeve të ligjshme të krijimit të të ardhurave të ligjshme, të personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e pasurive mbi të cilat ushtron të drejta subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

12. Komisioneri Publik konstaton të nevojshme vlerësimin e çështjeve të verifikuara gjatë rivlerësimit të kriterëve përkatëse të subjektit konkret, edhe mbi jurisprudencën e pritshme orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështje të ngjashme që janë në fazën e shqyrtimit gjyqësor nga ky Kolegj. Për sa kohë, eventualisht, konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit realizohet pasi është analizuar secili nga kriteret përkatëse, por edhe në një vlerësim të përgjithshëm të procedurave, Kolegji do të mund ta ushtrojë juridiksionin e tij rivlerësues/kontrollues për të tria kriteret e rivlerësimit.

13. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 352, datë 1.3.2021, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

II.1. Analiza e shkaqeve të ankimit

II.1.A. Për vlerësimin e pasurisë

14. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016, si dhe jurisprudencës të Kolegjit, Komisioneri Publik

mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike). Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

14.1 Nga verifikimi i akteve rezultojnë se hetimi i Komisionit mbi verifikimin e burimeve të ligjshme të personave të tjerë të lidhur, burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurive në pronësi apo posedim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me subjektin, deklaruar kryesisht në formën e dhurimeve ndër vite, nuk paraqitet i plotë, përkundrejt rrethanave që janë konstatuar.

14.2 Në rastet e shumave të deklaruara si të dhuruara nga personat e tjerë të lidhur, në eventualitetin e konsiderimit të këtyre të ardhurave si të ligjshme, në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, Komisioni rezultojnë të ketë realizuar një interpretim ligjor, si në lidhje me konsiderimin e burimit të krijimit të këtyre shumave, ashtu dhe në lidhje me konsiderimin e ligjshmërisë së tyre, lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore.

14.3 Nisur nga praktikat e mëparshme të shqyrtimit të vendimeve të Komisionit, Komisioneri Publik nënvizon se jurisprudenca e Kolegjit në lidhje me interpretimin e dispozitës së nenit D të aneksit të Kushtetutës, tashmë është e konsoliduar, duke i konsideruar si kumulative ekzistencën njëkohësisht të burimeve të ligjshme dhe pagesën e detyrimeve tatimore për shumat e rrjedhura nga burimet e ligjshme, në mënyrë që të ardhurat të konsiderohen si të ligjshme për efekt të krijimit të pasurisë nga subjektet e rivlerësimit.

14.4 Referuar kësaj jurisprudence të Kolegjit, përjashtimi nga detyrimi i pagesës së detyrimeve tatimore të të ardhurave të krijuara nëpërmjet burimeve të ligjshme, lejohet vetëm në ato raste kur ka parashikime të posaçme ligjore për përjashtimin e të ardhurave që vijnë nga burime të ligjshme⁶.

14.5 Po t’i referohemi arsyetimit që Komisioni bën në vendimin e tij konkret⁷, konstatohet se për dy nga pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit, ku vlera e të ardhurave që vijnë nga dhurimet e deklaruara nga znj. ***. ***. (person tjetër i lidhur) shkon në shumën **8 mln ALL**, është analizuar ligjshmëria e burimit të krijimit të të ardhurave, duke iu referuar më së shumti veprimeve juridike të lejuara nga ligji (kontrata shitje) për tjetërsimin e pronësisë së pasurive të paluajtshme, ku dhuruesja, znj. ***. ***, ka qenë në cilësinë e shitësit.

14.6 Ndërkohë, në lidhje me pagesën eventuale të detyrimeve tatimore që rrjedhin nga dhurimi i këtyre shumave, duke iu referuar argumentimit të vendimit të Komisionit⁸, duket se ky i fundit nuk ka konstatuar dhe arsyetuar nëse dhurimet duhet të jenë ose jo në mesin e të ardhurave që përjashtohen nga pagesa e detyrimeve tatimore.

14.7 Në vendimin konkret, në analizën përkatëse financiare të Komisionit, vetë ky i fundit, nga shuma totale e dhuruar ndër vite nga personat e tjerë të lidhur, ka bërë zbritjen matematike të

⁶ Referohuni në prg. 22.12, 22.13, vendim (JR) nr.19, datë 26.7.2019, i Kolegjit.

⁷ Referohuni në prg. 19, 55, vendim nr. 352, datë 1.3.2021, i Komisionit.

⁸ Shihni po aty.

vlerës së detyrimit tatimor⁹, duke e konsideruar në përfundim shumë e kësaj diference, në mesin e të ardhurave të ligjshme.

14.8 Nisur nga ky arsytim i përdorur në hartimin e analizës financiare, duket se Komisioni ka konstatuar se, në bazë të legjislacionit fiskal në fuqi, shumat e dhuruara kanë qenë objekti i detyrimeve tatimore, por nuk ka argumentuar më tej në lidhje me këtë interpretim ligjor, në kuptim të dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

14.9 Në referencë të sa parashtruar më lart, nënvizojmë se verifikimi i kriterëve ligjore për të arritur në përfundimin se, në rastin e vlerave të dhuruara nga ana e personave të tjerë të lidhur, gjendemi përpara të ardhurave të ligjshme në zbatim të nenit D të aneksit të Kushtetutës, ka qenë pjesë e praktikave të mëparshme të shqyrtimit të vendimeve të Komisionit nga ana e Komisionerit Publik, bazuar dhe në Rekomandimin e ONM-së.

14.10 Në Kolegj është në fazën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor, ankimi i Komisionerit Publik ushtruar kundër vendimit nr.161/2019 të Komisionit, ankim i ushtruar bazuar edhe në Rekomandimin përkatës të ONM-së.

14.11 Referuar këtij ankimi, që është në fazën përfundimtare të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, këtij të fundit, në zbatim të pikës 2, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, i është kërkuar¹⁰ nga Komisioneri Publik, bazuar edhe në Rekomandimin përkatës të ONM-së¹¹, orientim për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme që kanë të bëjnë me: (i) pagesën e detyrimeve tatimore në rastin e të ardhurave që burojnë nga dhurimet dhe (ii) mospagimin e tatimeve në kohën e duhur (të përfitimit të të ardhurave).

14.12 Në të tilla rrethana, orientimi që pritet të japë Kolegji, në vendimin e tij përfundimtar për ankimin e Komisionerit Publik ndaj vendimit nr.161/2019, eventualisht do të ketë ndikim edhe në shqyrtimin gjyqësor të ankimit konkret të Komisionerit Publik, si dhe disa prej ankimeve të tjera të paraqitura nga Komisioneri Publik, që priten të gjykohen nga ana e Kolegjit.

14.13 Në vijim, lidhur me verifikimin e rrethanave faktike dhe juridike që lidhen, ndër të tjera, me nevojën e interpretimit ligjor për sa i takon të ardhurave që rrjedhin nga dhurimet, nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave periodike vjetore me Deklaratën “Vetting”, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimit të ligjshëm të pasurive, rezulton si vijon:

15 Pasuria nr. 1 - Apartament banimi me sipërfaqe 82 m², në Vlorë

15.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi në Vlorë, me sipërfaqe 82 m², nr. ***/**+**, blerë në vitin 2002. Vlera: 6.000.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat e mia dhe të bashkëshortit, kursimet familjare dhe kursime të prindërve të bashkëshortit.* Pjesa takuese: 50%.

15.2 Në DV-2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi 2+1, 80 m², në Vlorë, lagjja: “****”, rr.: “****”, nr. pasurie ***/**+**-*** Z. K. ***. Vlera: 1.900.000 lekë. Burimi i krijimit: Kursime në vite nga familja e origjinës së bashkëshortit.* Pjesa takuese: 50%.

⁹ Referohuni në prg. 19, vendim nr. 352, datë 1.3.2021, i Komisionit.

¹⁰ Referohuni në prg. 54.9, 59.12, 60, 60.1, ankim i IKP-së, datë 8.8.2019.

¹¹ Referohuni në pikën 5, Rekomandim i ONM-së për ushtrim ankimi, datë 24.7.2019.

15.3 Komisioni, fillimisht, për këtë pasuri ka konstatuar, ndër të tjera, se subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur kanë pasur mundësi në vitin 2002 për blerjen e kësaj pasurie me burime të ligjshme financiare, ndonëse nuk rezulton e provuar pagesa e tatimit mbi të ardhurat nga shitjet e pasurive të paluajtshme.

15.4 Pas administrimit të provave dhe pretendimeve të subjektit, në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me ekzistencën e detyrimit të shlyerjes së detyrimeve tatimore për burimin e deklaruar në formën e dhurimit nga znj. ***. ***. të vlerës prej **5.307.404 lekë**, Komisioni ka arsyetuar se: [...] *Lidhur me pretendimin mbi të ardhurat e përfituara nga vjehrra e subjektit, në shitjen e pasurisë së paluajtshme në vitin 1997, Komisioni ka vlerësuar se nga analiza e legjislacionit tatimor në fuqi në momentin e transaksionit të lartpërmendur¹², për çmimin e shitjes mbi 6.000.000 lekë, detyrimi tatimor përkatës ka qenë 3% e çmimit, shumë kjo e cila është zbritur nga llogaritja e të ardhurave të vjehrrës së subjektit në analizën financiare [...].*

16. Pasuria nr. 2 - Apartament banimi me sipërfaqe totale 121.6 m², në Tiranë

16.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi në Tiranë, me sipërfaqe totale 121,6 m², me kontratë sipërmarrje në vitin 2005. Vlera: 60.800 euro. Burimi i krijimit: (i) 1.000.000 lekë, të përfitur nga shitja e pjesës time takuese në apartamentin e privatizuar; (ii) 30.000 euro, të marra hua; (iii) 2.700.000 lekë, të dhëna nga prindërit e bashkëshortit; (iv) kursime nga të ardhurat. Pjesa takuese: 50%.*

16.2 Në DV-2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Blerje apartament me sipërfaqe 121.6 m² (2+1), në rr.: “***. ***”, Tiranë. Vlera: 60.800 euro. Burimi i krijimit: (i) 1.000.000 lekë nga shitja e shtëpisë prindërve; (ii) 2.700.000 lekë hua nga prindërit e bashkëshortit; (iii) 30.000 euro të marra hua. Pjesa takuese: 50%.*

16.2.1 Lidhur me burimet e deklaruara të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni ka analizuar çdo burim të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

16.2.2 Për sa i takon burimit të deklaruar në formën e dhurimit të një vlere prej **2.700.000 lekë**, nga prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar se: [...] *Lidhur me pagesën e tatimeve mbi shumat e realizuara nga shitja e pasurive të paluajtshme, përpos shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, trupa gjykuese çmon se, nisur nga përmbajtja e dispozitave ligjore dhe nënligjore në periudhat përkatëse, konstatohet se legjislacioni në fuqi dhe, konkretisht, Dekreti nr.1673, datë 20.12.1996, parashikonte se: “Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të hipotekës nuk regjistrojnë kalimin e pronësisë pa u paraqitur dokumenti që vërteton pagimin e tatimit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni”. Nisur nga kjo dispozitë, për sa kohë në rastin konkret është provuar regjistrimi i pasurive të shitura në emër të palëve blerëse, kryerja e pagesave të detyrimeve tatimore duhet të konsiderohet e realizuar plotësisht dhe paraprakisht këtij veprimi deklarativ. Për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri [...].*

16.2.3 Për sa i takon huas me një vlerë prej 30.000 euro, të marrë nga shtetasi ***. ***, pas provave të administruara nga subjekti mbi burimin e ligjshëm të shtetasit ***. ***, për të dhënë huan në shumën 30.000 euro subjektit të rivlerësimit, në përfundim të hetimit për këtë

¹² Dekret nr. 1673, datë 20.12.1996, ligji nr. 8189, datë 30.1.1997, “Për miratimin me ndryshime të Dekretit nr. 1673, datë 20.12.1996, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, të ndryshuar.

burim, pasi ka administruar provat e paraqitura në përgjigje të pyetjeve të pyetësorit nr. 2¹³, Komisioni ka vlerësuar se: [...] *duket se personi tjetër i lidhur, ***, ***, ka pasur burime të ligjshme financiare për dhënien e huas në vlerën 30,000 euro, me burim të ligjshëm nga mjetet monetare të shoqërisë [...].*

16.2.4 Rezulton se, ndërkohë, DRT Vlorë, me shkresën nr. ***/*** prot., datë ***.1.2020, konfirmon se fitimi i deklaruar nga ky subjekt tregtar për vitet 1994-1996 është në shumën totale prej 572.180 lekë, për vitet 1997-2004, subjekti tregtar ka deklaruar vetëm xhiro vjetore, ndërsa për vitet 2005-2006, subjekti ka deklaruar të ardhura, por nuk ka depozituar bilanc fizik në dosje. Komisioni në vendim, në lidhje me përmbajtjen e kësaj korrespondencë të tij me DRT-në dhe atë me QKB-në, duket të mos jetë arsyetuar, në raport me përfundimet e arritura.

17. Në lidhje me analizën financiare të mbulimit me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, për periudhën 2003-2016

17.1 Bazuar në aktet në dosje, Komisioni ka kryer dhe një analizë financiare në lidhje me verifikimin e mbulimit me burime të ligjshme të shpenzimeve dhe kursimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të për periudhën 2003-2016.

17.2 Lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës së deklarimit, Komisionit, fillimisht, i ka rezultuar se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk mbulojnë me burime të ligjshme, nga të ardhura të ligjshme, shpenzimet, investimet dhe kursimet, për një diferencë negative në vlerën prej – 1.106.588 lekë, për të gjithë periudhën e deklarimit.

17.3 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, ka kundërshtuar një pjesë të zërave përbërës të analizës financiare, duke paraqitur pretendime dhe prova lidhur me: (i) të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti; (ii) të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit; (iii) të ardhurat nga interesat e depozitave, si dhe (iv) shpenzimet për interesat dhe principalin e paguar për kredinë pranë *** Bank.

17.4 Komisioni, pasi ka vlerësuar pretendimet dhe provat e depozituara nga subjekti, në përfundim, ka konkluduar se pamjaftueshmëria e konstatuar për periudhën 2003-2016 reduktohet për një diferencë negative në vlerën prej – 607.922 lekë.

17.5 Komisioneri Publik konstaton se, referuar edhe vlerësimit të Kolegjit mbi çështjet e trajtuara më sipër në këtë ankim për kriterin e pasurisë, duket se lind nevoja e rivlerësimit të zërave përbërës të analizës financiare të kryer nga Komisioni, konkretisht si më poshtë: (i) “kursime të vitit/cash, të padepozituara në asnjë bankë”, (iii) “të ardhura të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit” dhe “të ardhura të subjektit të rivlerësimit”; (iv) “shpenzime jetesë”, për vitin 2007 dhe (v) “shpenzime udhëtimi”, referuar metodologjisë së përdorur nga Kolegji në jurisprudencën e deritanishme.

¹³ (i) Vendim datë ***.1.2005, i Asamblesë së ortakëve të shoqërisë “****” sh.p.k. për dhënie huaje; (ii) kontratë shitblerje, datë ***.3.1998, (iii) lëvizje bankare të shoqërisë “****” sh.p.k. gjatë vitit 2005 pranë ***-së; (iv) korrespondencë me DRT Vlorë.

II.1.B. Kontrolli i aftësive profesionale

18. Lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, rezulton se Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka analizuar ankesën nr.*** prot., datë ***.6.2014, të përmendur në raportin e organit ndihmës, në kapitullin: “*Të dhëna arkivore të KLD-së*”, informacion nga Kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, mbi cenimin e vendimit nr. ***, datë ***.9.2013¹⁴, të Gjykatës së Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë ***.12.2013, të Gjykatës së Lartë.

18.1 Komisioni, lidhur me analizimin e ankesës së lartpërmendur, ka kërkuar informacion nga KLGJ-ja¹⁵, e cila me shkresën nr. ***/*** prot., datë ***.9.2020, i ka vënë në dispozicion Komisionit kopjen me nr.***, datë ***.6.2014, të njësuar me informacionin periodik të Kryetares së Gjykatës së Apelit Vlorë.

18.2 Nisur nga fakti se informacioni ka ardhur nga raportimi i Kryetarit të Gjykatës, nga Inspektorët e KLD-së¹⁶, bazuar në nenin 34/2 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të KLD-së”, ndër të tjera, është vlerësuar: [...] *(1) vendimi penal nr. ***, datë ***.9.2013, t’u evidentohet gjyqtarëve ***, ***, I. B. dhe ***, ***, për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të tyre [...].*

18.3 Nga aktet e përcjella nga KLGJ-ja ka rezultuar se:

18.3.1 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë ***.5.2013, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës. Caktimin e masës së sigurimit ‘arrest me burg’ ndaj shtetasit ***. ***, i biri i ***, dtl. ***.5.1957, banues në Vlorë”.

18.3.2 Mbi ankimin e paraqitur nga mbrojtësi, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë ***.6.2013, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr.***, datë ***.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe caktimin e masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, çdo të hënë të parë të çdo muaji, ora 12.00”.

18.3.3 Mbi rekursin e prokurorit, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë ***.12.2013, ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr.***, datë ***.6.2013, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.***, datë ***.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë”.

18.3.4.1 Në lidhje me vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, ku subjekti i rivlerësimit ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se: [...] *në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje, Gjykata e Apelit Vlorë është vënë në dijeni të vendimit nr. ***, datë ***.5.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili ka deklaruar ikjen e shtetasit ***, ***, në të tilla rrethana, vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë çmohet nga ana e këtij Kolegji se është marrë në kundërshtim të hapur dhe me përcaktimet e nenit 228/3/b të Kodit të Procedurës Penale dhe me Vendimin Unifikues nr.7, datë 14.10.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [...].*

18.4 Subjekti i rivlerësimit, lidhur mesa më lart, ndër të tjera, është shprehur se: [...] *Nga aktet procedurale të Gjykatës së Lartë konstatohet se vendimi për deklarimin e ikjes përmendet vetëm në fjalën e prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme para Gjykatës së Lartë dhe nuk është aspak i administruar në dosje, madje, në dosje nuk ka asnjë akt tjetër shkresor për të vërtetuar ekzistencën e kësaj të dhëne. Shkaku i evidentuar nga Gjykata e Lartë nuk lidhet me*

¹⁴ Relator në këtë vendim gjyqësor ka qenë gjyqtari ***, ***, dhe anëtarë I. B. subjekti i rivlerësimit, dhe ***, ***.

¹⁵ Shkresa nr. *** prot., datë ***.8.2020, e Komisionit drejtuar KLGJ-së.

¹⁶ Referohuni materialit të përgatitur nga inspektorët e KLD-së z. ***, ***, dhe z. ***, ***, “Relatim mbi verifikimin e informacionit të paraqitur nga Kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë”, drejtuar zëvendëskryetarit të KLD-së.

zbatimin e ligjit, por dukshëm lidhet me vlerësimin e një rrethane që nuk i është nënshtruar fare hetimit gjyqësor e konkretisht të një vendimi mbi deklarin e ikjes. Kjo rrethanë nuk është pretenduar as në rekurs prej prokurorit [...].

18.5 Nga përmbajtja e vendimit, duket se për këtë çështje të trajtuar gjatë hetimit administrativ, qëndrimi i trupës së Komisionit është ometuar, mungon, duke mos analizuar eventualisht pretendimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit në raport me përmbajtjen e dispozitave të neneve 245-249 të K.Pr.P., referuar dhe vendimit të ndërmjetëm datë ***.6.2013, që ka marrë vetë trupa gjyqësore e Gjykatës së Apelit Vlorë.

III. Kërkimi i ankimit

19. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa ka disponuar Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik nuk vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

20. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

21. Duke nënvizuar nevojën për të arritur në përfundime në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave që kanë për burim dhurimet nga personat e tjerë të lidhur, të bazuara në jurisprudencën orientuese të Kolegjit, interpretim ligjor ky që ndikon në vlerësimin tërësor të kësaj çështjeje;

22. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të aneksit të Kushtetutës, neneve 4, 30-34, 40-44, pikave 3, 4 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

23. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit, të çelë hetimin gjyqësor dhe, në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 352, datë 1.3.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ose
- Ndryshimin e këtij vendimi.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA